



# PROGRAMET E EDUKIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT

**Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë**

**Adresa:** Rruga "Pjeter Bogdani", P. 39/1, K. 5, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri

**Tel/Fax:** (+355/4) 2245 101

**E-mail:** [info@shukalb.al](mailto:info@shukalb.al)

**Web:** [www.shukalb.al](http://www.shukalb.al)

## Rreth Shoqatës Ujësllës Kanalizime të Shqipërisë


Shoqata Ujësllës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Në përputhje me objektivin e misionit të tij SHUKALB ofron një larmishmëri programesh edukuese dhe ndërgjegjësuere për nxënësit dhe studentët.

## Programet Edukuese dhe Ndërgjegjësuere

SHUKALB ka një angazhim serioz lidhur me ndërgjegjësimin dhe investimin në të ardhmen e sektorit të ujit. Sipas këtij angazhimi, sjellja e çështjeve të ujit në vëmendjen e sa më shumë njerëzve zë një vend të rëndësishëm në punën e shoqatës. Çdo program fokusohet në rritjen e ndërgjegjësimin në nivele të ndryshme të shoqërisë për mbrojtjen dhe përdorimin e burimeve ujore.

SHUKALB ka një eksperiencë të gjatë në zhvillimin dhe ofrimin e programeve edukuese dhe ndërgjegjësuere. Më poshtë mund të shihni zhvillimin e tyre sipas rendit kronologjik.



Programet edukuese zhvillohen në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, së bashku me mbështetjen e shoqërive ujësllës kanalizime në shkollat përkatëse të përfshira në program dhe financohen nga kompani lokale Shqiptare.

### "Miq të Ujit"

Ky program është ofruar për herë të parë në vitin 2007 dhe ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimin tek nxënësit e klasave të 3-ta në të gjithë Shqipërinë. Në 2008 u vlerësua si "Programi më i mirë edukativ për shkollat" nga Shoqata Ndërkombëtare e Ujit. Që prej fillimit e deri më sot ka përfshirë mbi 35,000 fëmijë nga e gjithë Shqipëria.

**Struktura:** Programi zhvillohet brenda një periudhe 9 mujore. Nxënësit marrin njohuritë bazë rreth ujit. Në fund ata i shprehin këto njohuri në formën e një vizatimi duke nxjerrë në pah rëndësinë e ujit, mbrojtjen dhe kursimin e tij.

Me këto punime, secila shkollë mban ekspozitën lokale prej së cilës dalin tre punimet më të mira. SHUKALB mbledh këto vizatime dhe i paraqet në ekspozitën "Uji përmes syve të fëmijëve". Vizatimet vlerësohen nga një komision i pavarur.

Fëmijët, vizatimet e të cilëve janë përzgjedhur si 12 më të mirat, bëhen pjesë e ceremonisë së çertifikimit dhe ndarjes së çmimeve. Me këto vizatime përgatiten dhe printohen kalendarë të cilët shpërndahen më pas në të gjithë Shqipërinë për të rritur më tej ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm në vend.

### "Sfida Botërore e Monitorimit të Ujit"

"Sfida Botërore e Monitorimit të Ujit" është një program kombëtar i cili angazhon nxënësit e klasave të 8-ta në monitorimin e burimeve ujore lokale. Ky program është ofruar për herë të parë në vitin 2012 dhe deri më sot, më shumë se 6 000 nxënës janë angazhuar në të.

**Struktura:** Programi zhvillohet brenda një periudhe 9 mujore. Nxënësit pasi marrin gjithë instruksionet dhe mjetet e nevojshme dhe monitorojnë katër parametrat kryesorë të ujit:

- oksigjeni i tretur;
- turbiditeti;
- temperatura;
- pH.

Pas çdo monitorimi në terren të burimeve ujore, rezultatet e përfituara hidhen online. Këto rezultate janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit të programit "Sfida Botërore e Monitorimit të Ujit": [www.worldwatermonitoringday.org](http://www.worldwatermonitoringday.org)

### "Panairi Shkencor" për Shkollat e Mesme

Programi "Panairi Shkencor" për shkollat e mesme ka për qëllim të inkurajojë mendimin analitik dhe punët eksperimentale mes nxënësve të klasave të 11-ta të shkollave të mesme. Ky program është implementuar për herë të parë në shkollën "Harry Fultz" dhe më pas SHUKALB e ka përhapur këtë program dhe ka angazhuar në të nxënës të shkollave nga e gjithë Shqipëria.

**Struktura:** Nxënësit pasi marrin gjithë instruksionet e nevojshme ndahen në grupe dhe realizojnë punë kërkimore rreth një teme e cila ka në qendër të saj "ujin".

Nxënësit i prezantojnë projektet e punuara në "Panairin Shkencor" lokal, panair ky i organizuar nga shkolla, prej së cilit dalin dy projektet më të mira. Projektet fituese të secilës shkollë bëhen pjesë e "Panairit Shkencor" kombëtar, i organizuar nga SHUKALB. Një komision i pavarur vlerësimi, i përbërë nga pedagogë, mësues, specialist, etj., përzgjedh 3 projektet më të mira.

### Programi i "Praktikës së Punës"

Programi i "Praktikës së Punës" zhvillohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, shoqëritë ujësllës kanalizime,

dhe kompanitë private, të cilët ofrojnë një praktikë verore pune për studentët.

Ky program është ofruar për herë të parë në vitin 2005 dhe deri më sot, më shumë se 600 studentë të degëve inxhiniri mjedisi dhe hidroteknike kanë zhvilluar këtë praktikë pune.

**Struktura:** SHUKALB identifikon studentët e masterit shkencor dhe profesional. Më pas SHUKALB i akomodon këta studentë në shoqëritë ujësllës kanalizime, kompanitë private ose institucionet shtetërore. Disa prej tyre përzgjidhen ta realizojnë këtë praktikë pranë SHUKALB.

Disa studentë janë punësuar në vendin ku ata kanë kryer praktikën.

### "Dita Botërore e Ujit"

Dita Botërore e Ujit është një program i Kombeve të Bashkuara, që organizohet çdo vit në datën 22 Mars. SHUKALB organizon aktivtete dhe asiston shoqëritë ujësllës kanalizime ta zhvillojnë në qytetin e tyre dhe të përhapin mesazhin e Ditës Botërore të Ujit. Festimi i kësaj dite është bërë një traditë për SHUKALB dhe shoqëritë ujësllës kanalizime anëtare të saj, që prej vitit 2007.

**Struktura:** SHUKALB përgatit fletëpalosje ndërgjegjësuere me mesazhe sensibilizuese, postera, baner dhe bluza me logon dhe mesazhin e Ditës Botërore të Ujit. Këto materiale përdoren më tej nga shoqëritë UK në organizimin e fushatave ndërgjegjësuere ose eventeve informuese për publikun në nivel lokal.

### "Java Kombëtare e Ujit"

Me vendim të Këshillit të Ministrave datë 10.09.2008, nr. 1248, java e parë e Nëntorit është shpallur "Java Kombëtare e Ujit" për Shqipërinë.

**Struktura:** Gjatë kësaj jave SHUKALB organizon një sërë aktiviteteve si:

- Ekspozita me vizatime të fëmijëve në kuadër të programit "Miq të Ujit";
- Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike;
- Mbledhje të Asamblesë;
- Shpërndarja e posterave sensibilizues në të gjithë Shqipërinë;
- Workshop-e me tema të ndryshme në fushën e ujit, etj.